Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-353/01-59497
Dt. 13. 10. 2026
P r i z r e n

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR KK – PRIZREN, me kërkesën e **Nexhat Palushi** me banim në rrugën Shën Flori nr. 2, në bazë të nenit 3. pika 1.1, 1.6, 1.7, 1.11, 1.11.1, 1.17, 1.24 dhe nenit 4 alineja 1 pika 1.2 e lidhur me nenin 5 alineja 1 pika 1.3 dhe 1.4 si dhe nenit 14 alineja 1 pika 1.4 dhe 1.5 si dhe në lidhje me nenin 15 alineja 1.1 dhe nenit 19 pika 2. të Ligjit për Ndërtim numër 04/L-110, dhe në harmoni me dispozitat e nenit 3 alineja 1 pika 1.1, 1.3, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.8 e lidhur me nenin 4, 5, 9 dhe 11 të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit numër 04/L-066 si dhe të Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit – Zona e Parë e Mbrojtjes numër 01/011-6604 të datës 18. 12. 2008, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 27, 44, 45, 46, 47, 48 e në lidhje me nenin 125 të LPPA-së numër 05/L031 të datës 25. 05. 2016, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. **LEJOHET: Nexhat Palushi** në zhvillimin e punimeve: **Renovimin e objektit – Hotelieri** në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-03450** Z.K. Prizren e evidentuar sipas Cerifikatës së pronës të dt. 19. 05. 2026, në rrugën „ Shën Flori".

II. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë të punuar nga ana e byros projektuese „Limit L & B" SH.P.K. (gjendja ekzistuese dhe gjendja e re).

III. Gjatë renovimit nuk lejohet kurrfarë ndryshimi, zgjerimi në gabarit dhe në etazhitet të objektit.

IV. Investitori duhet të përmbahet Vendimit të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve me numër 239-2 të datës 15. 07. 2026 dhe Rekomandimit të Këshillit për Trashëgimi Kulturore i Qendrës Historike të Prizrenit të datës 09. 09. 2026.

V. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspekcionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh dhe që të njoftojë QRTK-Prizren 7 ditë para fillimit të punimeve.

VI. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.

./..

A r s y e t i m

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se: Nexhat Palushi me banim në rrugën Shën Flori nr. 2 me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për renovimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për Renovimin e objektit - **Hotelieri** në ngastrën kadastrale numër P-71813068-03450 Z.K. Prizren.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – MMPH-së në Prishtinë, përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional:

Ylber Gashi, inxh. dip. ark.

D R E J T O R I :

Florent Ukaj, ecc i dip.